



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raport Konsultativ - KOSTT

Shqyrtimi i Pestë i Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE5 (2011-2012)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente eventuale nga palët e interesit. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

Prishtinë, 22 shkurt 2011

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE	i
1 Hyrje	2
2 Humbjet në transmision	2
3 Të Hyrat e Lejuara	3
3.1 Qasja	3
3.2 Shpenzimet operative	3
3.2.1 Mirëmbajtja	4
3.2.2 Shpenzimet e personelit	4
3.2.3 Shpenzimet e përgjithshme	5
3.2.4 Shërbimet ndihmëse	5
3.3 Shpenzimet kapitale, zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar	5
3.4 Përshtatjet	6
3.4.1 Përshtatjet për Shpenzimet Kapitale	6
3.4.2 Humbjet e Lejuara	7
3.5 Përmbledhje e të Hyrave të Lejuara	7
4 Çështje tjera	8
4.1 Mbulimi i pagesave për KEK-un	8
4.2 Vlerësimi i aseteve para vitit 2006	9
5 Propozimet e ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara	9

PËRMBLEDHJE

- Me aplikacionin e dorëzuar në kuadër të SHTE5, KOSTT-i ka kërkuar të Hyra të Lejuara për vitin 2011 në vlerë prej 17.4 milionë euro. Pas shqyrtimit të aplikacionit ZRRE ka vlerësuar se të Hyrat e Lejuara të mjaftueshme për KOSTT-in për vitin 2011 janë 14.1 milionë euro.
- ZRRE-ja propozon që kostot e lejuara për blerjen e humbjeve në transmision të jenë jenë 3.9 milionë euro, që korrespondojnë me humbjet e lejuara prej 2.3% apo me nivelin e arritur në vitin 2010. Për vitin 2010 humbjet e lejuara në SHTE4 kanë qenë 3.1%, ndërsa KOSTT-i ka kërkuar nivelin prej 2.7 % për 2011.
- ZRRE-ja propozon që kostot e lejuara për KOSTT-in, pa përfshirë humbjet e transmisionit, të jenë 10.2 milionë euro, krahasuar me 12.3 milionë euro të kërkuara nga KOSTT-i.
- Palët e interesit mund të komentojnë deri më 4 mars 2011.

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e shqyrtimit të aplikacionit për ngarkesat e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT), që do të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2011. Shqyrtimi përfshin si nivelin e të Hyrave të Lejuara që duhet të mblidhen nga KEK dhe KOSTT (tash e tutje “të licencuarit”) nga tarifat e ngarkesat e rregulluara në 2011-2012, ashtu edhe strukturën e këtyre tarifave dhe ngarkesave.

ZRRE ka pranuar aplikacionin e KOSTT-it më 28 janar 2011. Aplikacioni është publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, krahas këtij Raporti Konsultativ. Ky Raport paraqet vlerësimet dhe propozimet e ZRRE-së për Tarifën e Shrytëzimit të Sistemit të Transmisionit, Tarifën e Operatorit të Sistemit (OS) dhe Tarifën e Operatorit të Tregut (OT) që do të aplikohen nga KOSTT-i nga data 1 prill 2011.

ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komentet e tyre eventuale për qëndrimet e ZRRE-së të dhëna në këtë Raport. Komentet eventuale do të pranohen deri më datën 4 mars 2011, dhe duhet të dërgohen me e-mail në: ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, me titullin “Komente për SHTE5”. Komentet në formë të shkruar duhet të dërgohen në adresën e ZRRE-së: [Rr. Hamdi Mramori nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë](#), të dedikuara për “Departamentin për Tarifa dhe Çmime”.

Në shqyrtimin e aplikacionit të KOSTT-it, ZRRE është bazuar në Metodologjinë tarifore në fuqi, siç ka vepruar në shqyrtimet paraprake tarifore. Sipas Ligjit të sapo miratuar për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, do të ndryshohet metodologjia tarifore. Këto ndryshime duhet të bëhen brenda nëntë muajve pas miratimit të ligjit. Në ndërkohë, ZRRE do të vazhdojë të zbatojë Metodologjinë e deritanishme.

Duhet të theksohet se ZRRE ende nuk ka marrë ndonjë vendim për aprovimin e nivelit të tarifave. Propozimet e ZRRE-së në këtë dokument janë preliminare me qëllim të pranimit të komenteve eventuale nga palët e interesit.

2 Humbjet në transmision

Në aplikacionin e tyre KOSTT-i ka kërkuar humbjet në transmision në nivelin prej 2.7%. Propozimi i KOSTT-it është bazuar në Humbjet e Lejuara për vitin 2010 të cilat ishin 3.1%, por, sipas KOSTT-it, niveli i humbjeve të lejuara duhet të përfshijë gjysmën e reduktimit të humbjeve të zvogëluara në vitin paraprak.

ZRRE-ja thekson se KOSTT-i ka keqkuptuar mekanizmin nxitës të ZRRE-së dhe mënyrën e aplikimit të saj për humbjet në transmision. Rregullimet e propozuara të ZRRE-së për dallimin në mes të humbjeve të lejuara të transmisionit dhe atyre të realizuara janë përshkruar më vonë në këtë letër.

ZRRE-ja propozon që humbjet e lejuara të transmisionit për 2011, në proporcion të vëllimit që pritet të hyjë në sistemin e transmisionit, të vendosen në nivelin e realizuar në 2010 prej 2.3%. Propozimi

Të Hyrat e Lejuara

për humbjet e lejuara në kuadër të SHTE5 ka vlerën 130.5 GWh¹. Ky ndryshim vlerësohet në bazë të çmimit mesatar të blerjes me shumicë për vitin të energjisë elektrike prej 29.9 €/MWh dhe paraqet një ulje të të Hyrave të Lejuara të KOSTT-it prej 1.3 milionë eurosh.

Diskutimet e lartshënuara janë përshkruar në Tabelën 1.

Tabela 1: Humbjet në transmision

		HUMBJET NË TRANSMISION			
		SHTE4	Realizimi	Aplikacioni i KOSTT-it	Propozimi i ZRRE-së
Vëllimi i energjisë në hyrje	GWh	5,316.6	5,813.7	5,614.8	5,675.2
Humbjet e Lejuara		3.1%	2.3%	2.7%	2.3%
	GWh	166.0	131.0	151.6	130.5

3 Të Hyrat e Lejuara

3.1 Qasja

Të Hyrat e Lejuara për KOSTT-in janë përcaktuar duke shfrytëzuar qasjen e 'Ndërtimit me Blloqe'. Kostot e lejuara janë përcaktuar si shuma e shpenzimeve operative, zhvlerësimit për asetet e investuara pas vitit 2006, dhe kthimit të lejuar për asetet e financuara komercialisht pas vitit 2006.

Të Hyrat e Lejuara që do të mbledhen nga tarifat e rregulluara përcaktohen pasi që kostove të lejuara t'i zbriten të Hyrat e parregulluara. Për rastin e KOSTT-it, të Hyrat e parregulluara janë konsideruar të jenë zero. KOSTT-i do të duhej të kompenzohej për humbjet e shkaktuara nga rrjedhat ndërkombëtare të energjisë së tranzituar përmes rrjetit të tij. Mirëpo, për shkak se KOSTT-i nuk është anëtar i ENTSO-E-së, KOSTT-i nuk kompenzohet për humbjet në tranzit.

Në përgjithësi, përshtatjet janë aplikuar për diferencën ndërmjet shpenzimeve kapitale të lejuara dhe atyre të realizuara në vitin paraprak si dhe për ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara për ato kategori kostosh që janë jashtë kontrollit të të licencuarve.

Në këtë seksion, secili prej këtyre përbërësve të të Hyrave të Lejuara është shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar.

3.2 Shpenzimet operative

Nëse nuk përfshihen humbjet në transmision (të diskutuara më lartë), kërkesa e KOSTT-it për shpenzimet operative në kuadër të SHTE5 paraqet zbritje prej 5% krahasuar me shpenzimet e lejuara në kuadër të SHTE4, dhe rritje prej 35.8% krahasuar me vlerat e realizuara të raportuara në vitin

¹ KOSTT-i në aplikacionin e tyre ka kërkuar humbjet prej 151.6 GWh, ndërsa ZRRE ka marrë vlerën prej 172.3 GWh, duke u bazuar në Bilancin Energetik .

Të Hyrat e Lejuara

2010. Një krahasim i shpenzimeve operative të lejuara në SHTE4, të realizuara në 2010 dhe propozimet për vitin 2011 janë dhënë në Tabelën 2 në vijim:

Tabela 2: Shpenzimet Operative

SHPENZIMET OPERATIVE					
		SHTE4	2010 Realizuar	Aplikacioni	ZRRE
Mirëmbajtja	€000	3,914	1,113	2,361	1,113
Materiale/Shërbime	€000	52	37	52	52
Kostot e Personelit	€000	2,495	2,489	2,878	2,240
Sigurimi	€000	205	205	230	230
Të tjera	€000	1,181	1,190	1,888	1,631
Blerja e humbjeve	€000	5,582	3,150	5,184	3,903
Shërbimet Ndihmëse	€000	1,624	1,600	1,600	1,600
Gjithsej shpenzimet Operative	€000	15,053	9,784	14,193	10,769
Gjithsej pa humbje	€000	9,471	6,634	9,009	6,866

3.2.1 Mirëmbajtja

Në vitin 2010, të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it kanë përfshirë shpenzime të mirëmbajtjes prej 3.9 milion eurosh. Në ndërkohë, KOSTT-i ka shpenzuar vetëm 1.1 milion euro dhe pjesën e mbetur e ka kapitalizuar.

ZRRE-ja nuk mohon faktin se shpenzimet kapitale duhet të kapitalizohen atëherë kur ato zgjasin jetëgjatësinë e aseteve apo rrisin kapacitetin e tyre. Megjithatë, kapitalizimi i këtyre kostove nuk duhet të ndikojë që KOSTT-i të përfitojë në mënyrë të dyfishtë nga këto kosto – së pari t'i mbulojë si shpenzime operative, pastaj si të Hyra nga investimet kapitale. KOSTT-i ka përsëritur këtë praktikë edhe pas vërejtjeve të ZRRE-së gjatë Raportit të kaluar Konsultativ se kostot e shpenzimeve të mirëmbajtjes duhet të alokohen si duhet.

ZRRE vlerëson se për të shmangur kompenzimin e dyfishtë, kostot e kapitalizimit të mirëmbajtjes duhet të zbriten nga Shpenzimet Operative deri në vlerën e realizuar gjatë vitit 2010 prej 1.1 milion eurosh. Ndryshimi në mes të kësaj vlere dhe shumës së kërkuar nga KOSTT-i do të futet në RAB si investim kapital.

3.2.2 Shpenzimet e personelit

KOSTT-i ka parashtruar kërkesën për shpenzimet e personelit në shumën prej 2.9 milion eurosh. Kjo paraqet një rritje prej 15%, krahasuar me vlerën e lejuar në kuadër të SHTE4.

KOSTT-i e arsyeton kërkesën e tyre me punësimin e 25 punëtorëve shtesë dhe kërkon që kostot e personelit të rriten krahas Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë (IÇK). ZRRE ka krahasuar

kostot e personelit të lejuara për KOSTT-in me kostot e personelit të të punësuarve të tjerë me profil të krahasueshëm në sektorin e energjisë prej nga rezulton se kostot mesatare të personelit të KOSTT janë dukshëm më të mëdha se kostot mesatare të personelit të sektorit të energjisë në Kosovë. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE ka përfshirë në të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it koston e personelit prej 2.2 milion euro, që paraqet zbritje prej 10% nga shpenzimet e realizuara në vitin 2010.

3.2.3 Shpenzimet e përgjithshme

KOSTT-i ka propozuar që për shpenzimet e tjera të përgjithshme (Other Overheads) t'i lejohet një rritje prej 0.7 milionë eurosh apo 60% mbi vlerën e lejuar në kuadër të të Hyrave të Lejuara në SHTE4. KOSTT-i e arsyeton kërkesën e tyre me rritjen e kostove të sigurimit të pasurisë (obligim sipas Nenit 24 të licencës së OST-së) në vlerë prej 0.45 milion eurosh. Pjesa tjetër e kërkesës për rritjet e kostove të kësaj kategorie, nuk është arsyetuar nga KOSTT-i. ZRRE-ja propozon të lejojë një rritje të barabartë me rritjen e koston të sigurimit të pasurisë, por që të mos lejojë rritje tjera në këtë kategori.

3.2.4 Shërbimet ndihmëse

KOSTT-i ka propozuar një kompensim prej 1.6 milion eurosh për blerjen e shërbimeve ndihmëse në bazë të kontratës me OST-në e Shqipërisë, KESH-in, dhe me KEK gjenerimin. Kjo është e ngjashme me lejimet e propozuara në vitin e mëparshëm.

ZRRE-ja thekson se KOSTT-i në fakt nuk ka bërë pagesat për shërbimet ndihmëse në vitin 2010. Përveç kësaj, KOSTT-i ka sqaruar se nuk pret që të jetë në gjendje të prokurojë shërbime ndihmëse nga KESH-i gjatë vitit 2011 për shkak se interkonektori me Shqipërinë ende nuk është në gjendje të hyjë në funksion.

ZRRE nuk është e bindur se KOSTT-i do të përballlet me shpenzime të blerjes së shërbimeve ndihmëse gjatë vitit 2011. Për momentin, ZRRE ka përfshirë në të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it koston e shërbimeve ndihmëse. Megjithatë, ZRRE thekson se KOSTT-i duhet të ofrojë arsyetime shtesë për koston e kërkuar para vendimit final të ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara dhe tarifën. Nëse KOSTT-i nuk ofron arsyetimin e nevojshëm, ZRRE mban të drejtën që këto kosto t'i zbresë nga të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it.

3.3 Shpenzimet kapitale, zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar

ZRRE-ja ka vendosur të lejojë shpenzimet e planifikuara kapitale të përfshira në aplikacionin e tarifave të KOSTT-it. Nga shpenzimet kapitale prej 23.5 milion euro të lejuara në SHTE4, KOSTT ka realizuar vetëm 5.6 milion euro ose 24%. Për 2011, KOSTT ka planifikuar projekte kapitale në vlerë prej 24.9 milion euro, prej të cilave 20 milion euro janë donacione, 0.5 milion euro janë kredi ndërkaq 4.3 milion euro financohen nga KOSTT-i.

Të Hyrat e Lejuara

ZRRE-ja propozon rritje të investimeve kapitale për 1.2 milion euro nga ato të projektuara nga KOSTT, të cilat paraqesin transferin e pjesës së kapitalizuar nga mirëmbajtja te shpenzimet kapitale.

3.4 Përshtatjet

3.4.1 Përshtatjet për Shpenzimet Kapitale

Si në vitet e kaluara, ashtu edhe në këtë vit, ZRRE ka përshtatur të Hyrat e Lejuara për të zbritur mbikompensimin nga lejesat për investimet kapitale të cilat KOSTT-i në fakt nuk i ka realizuar. Këto lejime përfshijnë diferencën në mes të zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar për investimet e lejuara dhe ato të realizuara. Ky ndryshim kthehet me normë interesi 8.15% që paraqet normën komerciale për huatë afat-shkurtëra dhe që paraqet të Hyrat me interes apo pagesat që shoqërohen me këto mbikompensime.

Në rastin e KOSTT-it, kjo përshtatje paraqet zbritje të të Hyrave të Lejuara prej 0.59 milion eurosh. Rregullimet e ZRRE-së janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3: Përshtatjet për mos-realizimin e shpenzimeve kapitale

KOSTT - Përshtatjet		
Shpenzimet Kapitale		
Lejuara (Donacionet)	000€	14,959.0
Aktuale (Donacionet)	000€	1,497.0
Lejuara (Financim tjetër)	000€	8,557.0
Aktuale (Financim tjetër)	000€	4,138.0
Zhvlerësimi		
Jetëgjatësia	vite	35.0
Lejuar	000€	335.9
Aktuale	000€	80.5
Përshtatja	000€	-255.4
Kthimi		
MPKK		13.1%
Lejuar	000€	560.5
Aktuale	000€	271.0
Përshtatja	000€	-289.4
Gjithsej	000€	-544.9
<i>Norma e Interesit</i>		<i>8.15%</i>
Gjithsej pas Normës së Interesit	000€	-589.3

3.4.2 Humbjet e Lejuara

ZRRE-ja lejon KOSTT-in të mbajë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe atyre të realizuara të humbjeve në rrjetin e transmisionit, të cilat konsideron se janë shkaktuar nga KOSTT-i. Ndryshimet që ndodhin dhe të cilat janë jashtë kontrollit të KOSTT-it përshtaten në të Hyrat e Lejuara të shqyrtimit të ardhshëm tarifor.

Kjo llogaritje përfshin ndryshimin në mes të humbjeve të realizuara dhe atyre të lejuara që vijnë si pasojë e ndryshimit të nivelit të humbjeve, por jo edhe ndryshimin në humbje që mund të ndodhë si pasojë e ndryshimit të rrjedhave të energjisë në rrjetin e transmisionit. Në vitin 2010, vëllimi i realizuar i humbjeve në rrjetin e transmisionit ka qenë 131 GWh, ndërsa vëllimi i lejuar nga ZRRE-ja ka qenë 166 GWh. Nëse niveli i humbjeve në përqindje nuk do të ndryshonte, atëherë humbjet gjithsej do të arrinin nivelin 182 GWh. Prandaj, ZRRE vlerëson se ndryshimi i humbjeve si rezultat i ndryshimit në mes të vlerave të pritura dhe atyre të realizuara të rrjedhave të energjisë është 16 GWh. Ky ndryshim, kur vlerësohet me kostot e blerjes së energjisë të vitit 2010, kapë vlerën prej 0.5 milion eurosh, të cilat i shtohen KOSTT-it në të Hyrat e Lejuara të SHTE5, dhe e kompenzojnë KOSTT-in për ndryshimin e vëllimit në rrjedhat e energjisë elektrike. Ndryshimi në mes të humbjeve të realizuara dhe atyre të lejuara mbahet nga KOSTT-i, si kompenzim për reduktimin e humbjeve në rrjetin e transmisionit, dhe nxitje për reduktimin e humbjeve në vitet në vijim.

3.5 Përmbledhje e të Hyrave të Lejuara

Të Hyrat e kërkuara nga KOSTT-i në kuadër të SHTE5, të llogaritura nga Modeli i të Hyrave dhe i Tarifave i ZRRE-së, janë 17.4 milion euro. Kjo paraqet zbritje prej 3.5% krahasuar me të Hyrat e Lejuara në kuadër të SHTE4. Propozimi i ZRRE-së është që të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it për vitin 2011 të jenë 14.1 milion euro, që paraqet ulje prej 22% në krahasim me të Hyrat e Lejuara në kuadër të 2010.

Të hyrat e kërkuara nga KOSTT-i dhe propozimi i ZRRE-së janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 4: Të Hyrat e Lejuara- Propozimi i ZRRE-së

	TË HYRAT E LEJUARA			
		SHTË4	Aplikacioni I KOSTT	ZRRE
Shpenzimet Operative	€000	7,847	7,409	5,266
Zhvlerësimi	€000	1,857	2,039	2,056
Kthimi i Lejuar	€000	934	1,209	1,290
Blera e Humbjeve	€000	5,582	5,184	3,903
Shërbimet Ndihmëse	€000	1,624	1,600	1,600
GJITHSEJ KOSTOT E LEJUARA	€000	17,844	17,441	14,115
Përshtatjet	€000	235	-25	-25
GJITHSEJ TË HYRAT E LEJUARA	€000	18,080	17,416	14,090

Ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara të propozuara nga ZRRE-ja dhe të Hyrave të Lejuara në aplikacionin e KOSTT-it është 3.3 milion euro. Bashkërenditja në mes të aplikacionit të KOSTT-it dhe të Hyrave të lejuara nga ZRRE-ja është dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 5:Përshtatjet e të Hyrave të Lejuara

BASHKËRENDITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA	
	€000
Aplikacioni i KOSTT-it	17,416
Reduktimi për humbje	-1,281
Zbritja e kostos së personelit	-639
Mirëmbajtja e barazuar me vlerën e 2010	-1,248
Transferi i mirëmbajtjes në Capex	98
Shpenzimet tjera operative dhe sigurimi	-257
Propozimi i ZRRE-së	14,090

4 Çështje tjera

4.1 Mbulimi i pagesave për KEK-un

KEK-u dhe KOSTT-i janë ballafaquar një kontest për pagesat e KEK-ut ndaj KOSTT-it. Sipas KEK-ut, faturat e nëntorit dhe të dhjetorit nuk duhen paguar për KOSTT-in, pasi që pagesat e KEK-ut ndaj KOSTT-it deri në muajin tetor e kanë arritur nivelin e të Hyrave të Lejuara të KOSTT-it të SHTE4. Sipas KOSTT-it, faturat janë të llogaritura në mënyrë të duhur dhe duhen paguar plotësisht.

Propozimet e ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara

Në mungesë të kërkesës zyrtare për zgjedhjen e këtij kontesti, ZRRE-ja nuk do të ofrojë mendimin e saj në lidhje me kontestin në fjalë në këtë Raport Konsultativ. Megjithatë, ZRRE është e interesuar që të shmangë kontestet e tilla në të ardhmen.

KOSTT-i ka propozuar që kjo situatë të shmanget duke përmirësuar parashikimet e vëllimeve të transmetuara të energjisë, si dhe kërkesën e pikut. ZRRE pajtohet, mirëpo është e njohur me faktin se eliminimi i tërësishëm i devijimeve është pothuajse i pamundur.

Duke pasur parasysh këtë fakt, ZRRE propozon që të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it në kuadër të SHTE5 të caktohen në bazë të të Hyrave Tavan. ZRRE-ja cakton të Hyrat e Lejuara, në të cilat nuk përfshin humbjet meqenëse humbjet varen nga niveli i rrjedhave të energjisë, dhe tarifatat e ngarkesat e KOSTT-it. Nëse niveli i realizuar i humbjeve ndryshon nga niveli i parashikuar, atëherë ndryshimi duhet të përshtatet në shqyrtimin vijues tarifor. Kjo do t'i mundësojë KEK-ut të paguajë vetëm nivelin e të Hyrave të Lejuara për KOSTT-in dhe, në këtë mënyrë, i mundëson KOSTT-it e të Hyrave të Lejuara.

4.2 Vlerësimi i asetëve para vitit 2006

Kohë më parë, KOSTT-i ka bërë kërkesë për rivlerësimin e asetëve të periudhës para vitit 2006 që përfshihen në BAR me vlerën historike të zhvlerësimit të tyre (vlerën që figuron në pasqyrat financiare të audituara të KOSTT-it).

ZRRE-ja thekson se Ligji i ri për Rregullatorin e Energjisë përfshin, në nenin 43, një dispozitë si në vijim:

3. Gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, Zyra e Rregullatorit për Energji do të sigurojë që të licencuarve t'u mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, përfshirë:

3.6. koston normale të zhvleftësimit mbi të gjitha asetet e përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara, dhe "Baza e Aseteve të Rregulluara" nënkupton të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvleftësuar;

ZRRE ka theksuar në letrën e Parimeve dhe të Orarit të dërguar më 30 dhjetor 2010 se ky shqyrtim tarifor do të realizohet nën metodologjinë ekzistuese, sipas të cilës asetet e viteve para vitit 2006 kanë vlerë zero.

5 Propozimet e ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara

Propozimet e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara janë paraparë të jenë 14.1 milionë euro dhe paraqesin një ulje prej 22% krahasuar me ato të Lejuara për vitin 2010. Kjo do të reflektohet edhe në vendosjen e tarifave dhe ngarkesave të KOSTT-it.